



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr. 03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes për Ekstradim, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të nënshkruar në Prishtinë me 19 qershor 2013 dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 12 nëntor 2013.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-021-2013.

Prishtinë, më 15 nëntor 2013.

Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës

372

TRAKTAT PËR EKSTRADIM
NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Italisë, tani e tutje të referuara si "Palët Kontraktuese",

Me qëllim të promovimit të bashkëpunimit efektiv gjyqësor ndërmjet të dy vendeve për të parandaluar krimin në bazë të respektit të ndërsjellë të sovranitetit, barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë,

Duke marrë parasysh se ky qëllim mund të arrihet përmes lidhjes së një traktati bilateral për krijimin e një veprimi të përbashkët në çështjet e ekstradimit,

Janë pajtuar me, si vijon:

Neni 1

Detyrimi për të ekstraduar

Secila Palë Kontraktuese, në përputhje me dispozitat e këtij Traktati dhe në bazë të kërkesës së Shteti Kërkues, zotohet t'i ekstradojë palës tjetër çdo person, që gjendet në territorin e vet e që kërkohet nga Shteti Kërkues, me qëllim të kryerjes së procedurave penale ose të ekzekutimit të dënimit me burg ose çfarëdo mase tjetër që kufizon lirinë personale të shqiptuar ndaj një personi të tillë.

Neni 2

Veprat penale të ekstradueshme

1. Për qëllime të këtij Traktati, ekstradimi mund të lejohet kur:
 - a) Kërkesa për ekstradim bëhet me qëllim të ndjekjes penale dhe vepra penale është e dënueshme në bazë të ligjeve të të dyja shteteve me dënim me burg prej së paku një viti;
 - b) Kërkesa për ekstradim bëhet për ekzekutimin e dënimit ose çdo masë tjetër që kufizon lirinë personale për një vepër që është e dënueshme në bazë të ligjeve të të dyja shteteve dhe, në momentin e dorëzimit të kërkesës, kohëzgjatja e dënimit ose masës që kufizon lirinë e cila duhet të ekzekutohet është së paku gjashtë muaj.
2. Gjatë përcaktimit nëse, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, një vepër paraqet vepër penale në bazë të ligjeve të të dy shteteve, nuk do të ketë rëndësi nëse ligjet e të dy shteteve e cilësojnë veprën brenda të njëjtës kategori të veprës penale ose e emërtojnë veprën penale me terminologji të njëjtë.
3. Sa i përket veprave penale të ndërlidhura me tatimet dhe obligimet, tarifave doganore dhe këmbime të valutave, ekstradimi nuk duhet të refuzohet vetëm me arsyetimin se Shteti i Kërkuar nuk aplikon të njëjtin lloj të tatimeve dhe obligimeve ose nuk kanë të njëjtin lloj të dispozitave në lidhje me tatimet, obligimet, tarifave doganore dhe këmbimet valutore sikur ligjet e Shtetit Kërkuar.
4. Ekstradimi mund të lejohet edhe nëse vepra për të cilën ekstradimi është kryer jashtë territorit të Shtetit Kërkuar, me kusht që ligjet e Shtetit të Kërkuar lejojnë ndjekjen ligjore për një vepër të natyrës së njëjtë të kryer jashtë territorit të vet.
5. Nëse kërkesa për ekstradim ka të bëjë me dy ose më shumë vepra, ku secila prej tyre paraqet vepër penale në bazë të ligjeve të dy shteteve, dhe me kusht që njëra prej tyre përmbush kushtet e parapara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, atëherë Shteti i Kërkuar mund të lejojë ekstradimin për të gjitha ato vepra.

Neni 3

Arsyet që detyrojnë refuzimin

Ekstradimi nuk duhet të lejohet, nëse:

- a) Vepra për të cilën kërkohet ekstradimi nga Shteti i Kërkuar konsiderohet si vepër politike ose si vepër e ndërlidhur me një kategori të tillë të veprave penale. Në këtë drejtim, vepra të natyrës politike nuk do të konsiderohen, si veprat në vijim:
 - 1) Vrasja ose çdo vepër tjetër kundër jetës, integritetit fizik ose lirisë së Kryetarit të Shtetit ose të Qeverisë ose ndonjë anëtarit të familjes së tij/saj;
 - 2) Aktet terroriste, dhe çdo akt tjetër që nuk konsiderohet vepër penale politike në bazë të traktateve, konventave ose marrëveshjeve ndërkombëtare, palë të të cilave janë të dy shtetet;
- b) Shteti i Kërkuar ka arsye të konsiderueshme për të besuar që kërkesa për ekstradim është bërë me qëllim të ndjekjes penale ose dënimit të një personi për arsye të racës, gjinisë, fesë, gjendjes sociale, kombësisë ose opinionit politik, ose që pozita e atij personi në procedurat penale mund të paragjykohet nga cilado prej këtyre arsyeve;
- c) Vepra për të cilën kërkohet ekstradimi mund të dënohet nga Shteti Kërkues me një dënim është e ndaluar nga Shteti i Kërkuar;
- d) Shteti i Kërkuar ka arsye të konsiderueshme për të besuar që në Shtetin Kërkues, personi i kërkuar i është nënshtruar, ose do t'i nënshtrohet, procedurave për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi, të cilat nuk sigurojnë respektimin e të drejtave bazë të mbrojtjes ose një trajtim johuman dhe degradues ose ndonjë akti tjetër ose cenimin e të drejtave fundamentale të tij/saj. Në rast se procedurat janë kryer në mungesë të pandehurit, atëherë kjo nuk përbën arsye *per se* për refuzim të ekstradimit, nëse personi i kërkuar ka të drejtën e gjyqimit të ri me kërkesës së tij/saj, në bazë të ligjeve të Shtetit Kërkues;

- e) Në lidhje me veprën për të cilën kërkohet ekstradimi, personi i kërkuar veç është dënuar me një vendim të formës së prerë nga autoritetet kompetente të Shtetit Kërkues;
- f) Në lidhje me veprën për të cilën kërkohet ekstradimi, është bërë amnesti, falje e përgjithshme ose falje individuale nga ana e Shtetit Kërkues ose për shkak të parashkrimit ose ka ndonjë arsye tjetër për shuarje të veprës penale ose të dënimit.
- g) Vepra për të cilën kërkohet ekstradimi paraqet vetëm vepër ushtarake në bazë të ligjeve të Shtetit të Kërkuar;
- h) Shteti i Kërkuar i ka miratuar azilin politik personit të kërkuar;
- i) Shteti i Kërkuar konsideron se lejimi ekstradimit do të rrezikonte sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesat tjerë esencial të Shtetit ose të shkaktojë efekte të kundërta me parimet fundamentale të ligjeve të veta të brendshme.

Neni 4

Arsyet fakultative për refuzim

Ekstradimi mund të refuzohet nëse ekziston cilado nga rrethanat e mëposhtme:

- a) Vepra për të cilën kërkohet ekstradimi bie brenda juridiksionit të Shtetit të Kërkuar në përputhje me ligjet e veta të brendshme dhe personi i kërkuar është duke u ndjekur ose do të ndiqej, penalisht nga autoritetet kompetente të atij shteti për të njëjtën vepër për të cilën kërkohet ekstradimi;
- b) Shteti i Kërkuar, duke marrë parasysh seriozitetin e veprës penale dhe interesat e Shtetit Kërkues, konsideron që ekstradimi do të ishte në kundërshtim me aspektet humanitare siç janë moshën, gjendjen shëndetësore ose lloje tjera të rrethanave personale të personit të kërkuar.

Neni 5

Ekstradimi i shtetasve

1. Secila Palë ka të drejtën e refuzimit të ekstradimit të shtetasve të vet.
2. Në rast të refuzimit të ekstradimit dhe në bazë të kërkesës së Palës Kërkuese, Pala e Kërkuar duhet të dorëzojë rastin tek autoritetet e veta kompetente me qëllim të inicimit të procedurave penale kundër personit të kërkuar në bazë të ligjeve të veta të brendshme. Për këtë qëllim, Shteti Kërkues, përmes Autoriteteve Qendrore të përcaktuara në nenin 6 më poshtë, duhet t'i ofrojë Shtetit të Kërkuar, pa pagesë, dëshmitë, dokumentet dhe çdo material të dobishëm që ka në posedim.
3. Shteti i Kërkuar duhet t'i komunikojë Shtetit Kërkues brenda një afati të arsyeshëm, veprimin e ndërmarrë sipas kërkesës dhe rezultatit të procedurës.

Neni 6

Dorëzimi i kërkesës për ekstradim dhe Autoritetet Qendrore

1. Për qëllimet e këtij Traktati, Autoritetet Qendrore të caktuara nga Palët Kontraktuese duhet të përcjellin kërkesën për ekstradim dhe do të komunikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt ndërmjet tyre.
2. Autoritetet Qendrore janë Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë (Ministero della Giustizia) e Republikës së Italisë.
3. Secila Palë Kontraktuese përmes kanaleve diplomatike do t'i komunikojë Palës tjetër ndryshimin e Autoritetit Qendror të caktuar.

Neni 7

Kërkesa për ekstradim dhe dokumentet e nevojshme

1. Kërkesa për ekstradim duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë, aq sa është e mundur, ose si dokumente të bashkëngjitura, si vijon:
 - a) Të dhënat e Autoritetit Kërkues;

- b) Emrin, datën e lindjes, gjininë, kombësinë, profesionin, vendbanimin e personit të kërkuar, detajet e dokumentit identifikues të tij/saj dhe çdo informatë tjetër që mund të ndihmojë në përcaktimin e identitetit të personit ose të përcaktimit të lokacionit të tij/saj dhe të dhënat identifikuese nga policia, fotografitë dhe gjurmët e gishtërinjve të personit në fjalë;
 - c) Përshkrimi i kryerjes së veprës penale për të cilën kërkohet ekstradimi, duke përfshirë datën dhe vendin e kryerjes dhe klasifikimin ligjor;
 - d) Teksti i dispozitave përkatëse të ligjeve të aplikueshme, përfshirë dispozitat për kushtet për ndjekjen penale, parashkrimin dhe dënimin që mund të shqiptohet;
 - e) Tekstin e dispozitave ligjore që i japin juridiksion Shtetit Kërkuar, nëse vepra për të cilën kërkohet ekstradimi është kryer jashtë territorit të atij Shteti.
2. Përveç kërkesave nga paragrafi 1 të këtij neni, kërkesa për ekstradim duhet të shoqërohet edhe me:
- a) Originalin ose kopjen e vërtetuar të urdhër arrestit të lëshuar nga Autoriteti kompetent i Shtetit Kërkuar në rastet kur kërkesa ka për qëllim ndjekjen penale;
 - b) Originalin ose kopjen e vërtetuar të aktgjykimit që duhet zbatuar si dhe të dhëna për pjesën e vuajtur të dënimit në rastet kur kërkesa ka për qëllim ekzekutimin e dënimit ndaj personit të kërkuar.
3. Kërkesa për ekstradim, e nënshkruar zyrtarisht nga Autoritetet kompetente, dhe dokumentet përkatëse përcjellëse, duhet të shoqërohen me përkthim në gjuhën e Shtetit të Kërkuar, që është gjuha shqipe ose serbe për Republikën e Kosovës, dhe gjuha italiane për Republikën e Italisë.

Neni 8

Informatat shtesë

1. Nëse informatat e ofruara nga Shteti Kërkuar për të mbështetur kërkesën për ekstradim nuk janë të mjaftueshme që Shteti i Kërkuar të merr vendim në bazë të

këtij Traktati, atëherë Shteti i Kërkuar mund të kërkojë që brenda dyzet ditëve të dorëzohen informata shtesë.

2. Mosdorëzimi i informatave shtesë brenda afatit të paraparë në paragrafin I të këtij neni rezulton me refuzimin e kërkesës për ekstradim. Megjithatë, Shteti Kërkuës mund të bëjë një kërkesë të re për ekstradimin e personit të njëjtë dhe për të njëjtën vepër penale.

Neni 9

Vendimi

1. Shteti i Kërkuar vendos lidhur me kërkesën për ekstradim në përputhje me procedurat e parapara në ligjin e vet vendor dhe duhet të informoj Shtetin Kërkuës për vendimin e marrë, brenda një afati të arsyeshëm.
2. Nëse Shteti i Kërkuar refuzon tërësisht ose një pjesë të kërkesës për ekstradim, atëherë Shteti Kërkuës duhet të informohet për arsyet e refuzimit.

Neni 10

Parimi i Specialitetit

1. Personi i ekstraduar në përputhje me këtë Traktat nuk do të ndiqet penalisht, gjykohet, paraburgoset për qëllime të ekzekutimit të dënimit në Shtetin Kërkuës e as t'i nënshtrohet ndonjë mase tjetër që kufizon lirinë personale për çfarëdo vepre penale të kryer para dorëzimit, tjetër nga ajo për të cilin është lejuar ekstradimi, përveç nëse:
 - a) Personi i ekstraduar, pas lëshimit të territorit të Shtetit Kërkuës, kthehet vullnetarisht në Shtetin Kërkuës;
 - b) Personi i ekstraduar nuk e lëshon territorin e Shtetit Kërkuës brenda dyzet e pesë ditëve prej që ka pasur mundësinë ta bëjë atë. Megjithatë, periudha e tillë kohore nuk përfshin kohën gjatë së cilës personi nuk e lëshon Shtetin Kërkuës për arsye që janë jashtë kontrollit të tij/saj;

c) Shteti i Kërkuar pajtohet me atë. Në këtë rast, Shteti i Kërkuar, në bazë të kërkesës specifike nga Shteti Kërkues, mund të pajtohet për ndjekjen penale të personit të ekstraduar ose për ekzekutimin e dënimit kundër personit për një vepër të ndryshme nga ajo për të cilën është bërë kërkesa për ekstradim, në përputhje me kushtet dhe kufizimet e parapara në këtë Traktat. Në këtë drejtim:

1) Shteti i Kërkuar mund të kërkojë nga Shteti Kërkues përcjelljen e dokumenteve dhe informatave të parapara në nenin 7;

2) gjatë pritjes së vendimit për kërkesën e bërë, personi i ekstraduar mund të mbahet në paraburgim nga Shteti Kërkues për maksimum dyzet ditë nga dita e pranimit të kërkesës nga Shteti i Kërkuar, me kusht që kjo të jetë e autorizuar nga Shteti i Kërkuar.

2. Me përjashtim të asaj që është paraparë në pikën c) të paragrafit të mësipërm, Shteti Kërkues mund të marrë çdo masë të domosdoshme të paraparë me ligjet e saj për të ndërprerë periudhën e parashkrimit.

3. Në rastet kur klasifikimi ligjor i veprës me të cilën ngarkohet personi rikualifikohet gjatë procedurës, personi i ekstraduar mund të ndiqet penalisht dhe gjykohet për veprën e rikualifikuar, me kusht që ekstradimi është i lejuar në bazë të këtij Traktati edhe për këtë vepër të re.

Neni 11

Ri-ekstradimi tek shteti i tretë

Me përjashtim të rasteve të parapara në paragrafin 1, pikat a) dhe b) të nenit 10, Shteti Kërkues nuk mund të dorëzojë të një shtet i tretë, pa pëlqimin e Shtetit të Kërkuar, personin i cili i është dorëzuar dhe kërkohet nga një shtet i tretë për vepra të kryera para dorëzimit. Shteti i Kërkuar mund të kërkojë dorëzimin e dokumenteve dhe informatave të dhëna në nenin 7.

Neni 12

Arrestimi i përkohshëm

1. Në raste të urgjente, Shteti Kërkues mund të kërkojë arrestimin e përkohshëm të personit të kërkuar me kusht që të pasojë kërkesa për ekstradim. Kërkesa për arrest të përkohshëm bëhet me shkrim tek Autoritetet Qendrore të përcaktuara me nenin 6 të këtij Traktati, dhe dorëzohet në mënyrë të drejtpërdrejt ose përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) ose kanaleve tjera të pajtuara nga dy shtetet.
2. Kërkesa për arrest të përkohshëm përmban informatat e përcaktuara në nenin 7, paragrafi 1 të këtij Traktati dhe duhet të shprehë qëllimin për dorëzim të kërkesës formale për ekstradim. Shteti i Kërkuar mund të kërkojë informata shtesë siç parashihet me nenin 8.
3. Pas pranimit të kërkesës për arrest të përkohshëm, Shteti i Kërkuar duhet të ndërmerr masat e domosdoshme për të marrë në mbajtje personin e kërkuar dhe duhet të informoj Shtetin Kërkues për rezultatin e kërkesës, brenda një afati të arsyeshëm.
4. Arrestimi i përkohshëm dhe çdo masë tjetër kufizuese që veç janë shqiptuar, do të bëhet të pavlefshme nëse, brenda dyzet ditëve pas arrestimit të personit të kërkuar, Autoriteti Qendror i Shtetit të Kërkuar nuk pranon kërkesën formale për ekstradim.
5. Arrestimi i përkohshëm i pavlefshëm i paraparë në paragrafin 4 të këtij neni nuk pengon riarrestimin dhe ekstradimin e personit të kërkuar nëse Shteti i Kërkuar më vonë pranon kërkesën formale për ekstradim në përputhje me kushtet dhe kufizimet e këtij Traktati.

Neni 13

Kërkesat për ekstradim të bëra nga disa shtete

Nëse Shteti i Kërkuar pranon një kërkesë për ekstradim nga Shteti Kërkues dhe nga një apo më shumë shtete të treta për personin e njëjtë, për vepër penale të njëjtë ose

të ndryshme, Shteti i Kërkuar gjatë marrjes së vendimit se cilit shtet do t'i ekstradohet personi, duhet të merr parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, e në veçanti:

- a) seriozitetin e veprave të ndryshme;
- b) kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale;
- c) shtetësinë dhe vendbanimin e personit të kërkuar;
- d) datat përkatëse të dorëzimit të kërkesave; dhe
- e) mundësinë e ri-ekstradimit të mëvonshëm në një vend të tretë.

Neni 14

Dorëzimi i personit

1. Nëse Shteti i Kërkuar lejon ekstradimin, Shtetet duhet, brenda një afati të arsyeshëm, të pajtohen për kohën, vendin dhe çështjet tjera relevante për dorëzimin e personit të kërkuar. Shteti Kërkuës duhet të informohet edhe për kohëzgjatjen e mbajtjes në paraburgim të personit të kërkuar me qëllim të ekstradimit.
2. Afati për dorëzimin e personit të kërkuar duhet të jetë tridhjetë ditë nga data në të cilën Shteti Kërkuës informohet se është lejuar ekstradimi. Me kërkesë të Shtetit Kërkuës ose Shtetit të Kërkuar, koha e fillë mund të zgjatet edhe për pesëmbëdhjetë ditë.
3. Nëse Shteti Kërkuës nuk merr përsipër personin që duhet ekstraduar, brenda afatit kohor të paraparë në paragrafit 2 të këtij neni, Shteti i Kërkuar menjëherë do të lirojë atë nga mbajtja dhe mund të refuzojë kërkesën e re për ekstradim të bërë nga Shteti Kërkuës për atë person dhe për të njëjtën vepër, përveç nëse parashihet ndryshe në paragrafin 4 të këtij neni.
4. Nëse njëra nga shtetet nuk dorëzon apo merr përsipër personin që duhet ekstraduar brenda afatit të paraparë për arsye jashtë kontrollit të vet, atëherë Shteti në fjalë do të informoj shtetin tjetër dhe shtetet duhet të arrijnë pëlqimin

për një datë të re të dorëzimit. Pasojat e parapara në paragrafin 3 të këtij neni duhet të vazhdojnë së aplikuari.

5. Në rastet kur personi që ekstradohet arratiset në Shtetin e Kërkuar para përfundimit të procedurave penale ose para shqiptimit të dënimit nga Shteti Kërkues, atëherë ai person mund të ekstradohet prapë pas një kërkesë të re për ekstradim të bërë nga Shteti Kërkues për të njëjtën vepër. Shteti Kërkues nuk ka nevojë të dorëzojë dokumentet e parapara në nenin 7 të këtij Traktati.
6. Koha e kaluar në mbajtje, qoftë edhe arrest shtëpiak, nga data e arrestimit e deri te data e dorëzimit, do të llogaritet nga Shteti Kërkues gjatë caktimit të paraburgimit brenda procedurës penale apo të dënimit të shqiptuar në rastet e parapara në nenin 2, paragrafi 1.

Neni 15

Dorëzimi i shtyrë dhe dorëzimi i përkohshëm

1. Nëse personi i kërkuar ndiqet penalisht ose është duke kryer dënimin në Shtetin e Kërkuar për vepër të ndryshme prej asaj për të cilën kërkohet ekstradimi, Shteti i Kërkuar, pas lejitimit të ekstradimit, mund të shtyjë dorëzimin deri në përfundimin e procedurave penale ose në kryerjen e vuajtjes së dënimit. Shteti i Kërkuar do të informoj Shtetin Kërkues për një shtyrje të tillë.
2. Megjithatë, në bazë të kërkesës së Shtetit Kërkues, Shteti i Kërkuar, në përputhje me ligjet e veta, mund të dorëzojë përkohësisht personin e kërkuar te Shteti Kërkues me qëllim të kryerjes së procedurave penale, duke arritur pajtimin rreth kohës dhe modaliteteve për një dorëzim të përkohshëm të tillë. Personi i dorëzuar në këtë mënyrë duhet të mbahet në paraburgim gjatë qëndrimit në territorin e Shtetit Kërkues dhe duhet t'i kthehet Shtetit të Kërkuar brenda kohës që janë pajtuar. Koha e kaluar në paraburgim duhet të llogaritet si pjesë e dënimit që duhet të ekzekutohet në Shtetin e Kërkuar.

3. Përveç rastit të paraparë në paragrafin I të këtij neni, dorëzimi mund të shtyhet edhe në rastet kur, për shkak të gjendjes shëndetësore të personit të kërkuar, transferimi mund të rrezikojë jetën e tij/saj ose të përkeqësojë gjendjen. Në këtë drejtim, është e domosdoshme që Shteti i Kërkuar t'i dorëzojë Shtetit Kërkuar raportin e hollësishëm mjekësor të hartuar nga një institucion shëndetësor publik kompetent.

Neni 16

Procedura e thjeshtësuar e ekstradimit

1. Kur personi, ekstradimi i të cilit kërkohet, deklaron se pajtohet me ekstradim, për ekstradim mund të vendoset vetëm në bazë të kërkesës për arrest të përkohshëm, pa dorëzuar dokumentet e dhëna në nenin 7 të këtij Traktati. Megjithatë, Shteti i Kërkuar mund të kërkojë informata shtesë të cilat i konsideron të nevojshme për të lejuar ekstradimin.
2. Deklarata e pëlqimit të personit të kërkuar do të konsiderohet të jetë e vlefshme nëse bëhet me ndihmën e avokatit mbrojtës para një Autoriteti kompetent të Shtetit të Kërkuar, i cili ka për obligim të informojë personin e kërkuar për të drejtën e përfitimit nga procedura formale e ekstradimit, të drejtën e përfitimit nga mbrojtja e paraparë me parimin e specialitetit dhe të pakthyeshmërisë së deklaratës së tillë.
3. Deklarata duhet të futet në regjistrin ligjor në të cilën dëshmohet se kushtet për vlefshmërinë e deklaratës janë përmbushur.

Neni 17

Dorëzimi i sendeve

1. Me kërkesë të Shtetit Kërkuar, Shteti i Kërkuar, në përputhje me ligjet e veta, do të sekuestrojë sendet e gjetura në territorin e vet dhe të cilat personi i kërkuar i kishte në dispozicion dhe, pas lejimit të ekstradimit, duhet t'i dorëzojë ato sende

Shtetit Kërkues. Për qëllime të këtij neni, sendet në vijim duhet të sekuestrohen dhe t'i dorëzohen Shtetit Kërkues:

- a) sendet e përdorura për të kryer veprën ose çdo send tjetër ose çdo send i dobishëm që mund të shërbejë si dëshmi;
- b) sendet, si rezultat i kryerjes së veprës penale, që janë gjetur tek personi i kërkuar ose janë zbuluar më vonë.

2. Dorëzimi i të gjitha sendeve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të bëhet edhe në rastet kur ekstradimi, edhe pse i lejuar, nuk mund të zbatohet për shkak të vdekjes, zhdukjes ose arratisjes së personit të kërkuar.
3. Me qëllim të kryerjes së ndonjë procedure penale, Shteti i Kërkuar mund të shtyjë dorëzimin e sendeve të lartpërmendura deri në përmbylljen e procedurave të tilla ose mund t'i dorëzojë përkohësisht me kusht që Shteti Kërkues zotohet t'i kthejë ato.
4. Dorëzimi i sendeve të përmendura në këtë nen nuk duhet të merret si cenim i asnjë të drejte ose interesi legjitim të Shtetit të Kërkuar ose ndonjë pale të tretë mbi ato sende. Në rastet kur ka të drejta ose interesa të tilla, Shteti Kërkues duhet t'i kthejë pa kurrfarë kompensimi Shtetit të Kërkuar ose palës së tretë sendet e dorëzuara sa më shpejt që është e mundur pas përfundimit të procedurave.

Neni 18

Transiti

1. Çdo shtet mund të autorizojë transitin përmes territorit të vet të një personi që i është dorëzuar shtetit tjetër nga një shtet i tretë në përputhje me dispozitat e këtij Traktati, përveç nëse arsyet e interesit publik e parandalojnë një gjë të tillë.
2. Shteti që kërkon transitin duhet t'i dorëzojë shtetit nëpër të cilin duhet të bëhet transiti një kërkesë përmes Autoriteteve Qendrore, ose në raste urgjente përmes INTERPOL-it, e cila përmban të dhënat personale të personit në transit dhe një deklaratë të saktë të fakteve të rastit. Kërkesa për transit duhet të shoqërohet me një kopje të dokumentit që lejon ekstradimin.

3. Shteti nëpër të cilin duhet të bëhet transiti duhet të ketë në mbajtje personin gjatë kohës sa ai/ajo është në territorin e vet.
4. Nuk ka nevojë për autorizim për transit nëse shfrytëzohet transporti ajror dhe nuk parashihet aterim në territorin e shtetit të transimit. Nëse ndodh aterim i paparashikuar në territorin e shtetit të transimit, atëherë Shteti që kërkon transitin duhet të informoj menjëherë shtetin e transimit dhe ky i fundit duhet të mbajë personin e transportuar për maksimum 96 orë deri në pranimin e kërkesës për transit të paraparë në paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 19

Shpenzimet

1. Shteti i Kërkuar duhet të ndërmerë të gjitha masat e nevojshme dhe përkatëse në lidhje me kërkesën për ekstradim dhe duhet të merr përsipër shpenzimet.
2. Shteti i Kërkuar duhet të merr përsipër shpenzimet e shkaktuara në territorin e vet gjatë arrestimit të personit të kërkuar dhe mbajtjes së personit në fjalë deri në dorëzimin të Shteti Kërkues si dhe të gjitha shpenzimet e shoqëruara me sekuestrimin dhe ruajtjen e sendeve të përmendura në nenin 17.
3. Shteti Kërkues duhet të merr përsipër shpenzimet e shkaktuara për transportimin e personit të ekstraduar dhe çdo send të sekuestruar nga Shteti i Kërkuar deri te Shteti Kërkues si dhe shpenzimet e transimit të përmendura në nenin 18.

Neni 20

Informatat pasuese

Shteti Kërkues, me kërkesë të Shtetit të Kërkuar, duhet t'i ofrojë, në kohë të arsyeshme, Shtetit të Kërkuar informata për procedurat ose ekzekutimin e dënimit të shqiptuar për personin e ekstraduar ose informata për ekstradimin e personit në fjalë te shteti i tretë.

Neni 21

Raporti me traktatet tjera

Ky Traktat nuk duhet të parandalojë Shtetet që të bashkëpunojnë me njëra tjetrën për ekstradim në përputhje me traktatet tjera, palë e të cilave janë të dy Shtetet.

Neni 22

Konfidencialiteti

1. Shtetet pajtohen të ruajnë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe çdo informatë të përdorur në procedurën e ekstradimit si dhe çdo informatë tjetër relevante për atë ekstradim përfshirë edhe ato të fituara pas ekstradimit të personit.
2. Të dy Shtetet zotohen të respektojnë dhe ruajnë konfidencialitetin ose fshehtësinë e dokumenteve dhe informatave të pranuar nga Shteti tjetër dhe të dhëna Shtetit tjetër, kur kërkohet shprehimisht nga Shteti në fjalë.

Neni 23

Zgjidhja e kontesteve

1. Çdo kontest që shfaqet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Traktati duhet të zgjidhet përmes konsultimeve ndërmjet Autoriteteve Qendrore.
2. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, atëherë kontesti duhet të zgjidhet me konsultime përmes kanaleve diplomatike.

Neni 24

Hyrja në fuqi, amendamenti dhe ndërprerja


1. Ky Traktat duhet të hyjë në fuqi në ditën e pranimit të njoftimit të fundit përmes të cilit secila Palë Kontraktuese i komunikon zyrtarisht palës tjetër, përmes


- kanaleve diplomatike, që procedurat e brendshme përkatëse të ratifikimit janë kryer.
2. Ky Traktat mund të amendamentohet në çdo kohë përmes marrëveshjes së shkruar ndërmjet Palëve Kontraktuese. Çdo amendament i tillë do të hyjë në fuqi në përputhje me procedurën e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni dhe do të jetë pjesë përbërëse e këtij Traktati.
 3. Ky Traktat do të ketë kohëzgjatje të pakufizuar. Secila Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga ky Traktat në çdo kohë duke i dhënë njoftim me shkrim Palës tjetër përmes kanaleve diplomatike. Ndërprerja duhet të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës së dërgimit të njoftimit. Ndërprerja e zbatimit të këtij Traktati nuk do të ketë ndikim në procedurat e ekstradimit të filluara para ndërprerjes.
 4. Ky Traktat duhet të vlejë për çdo kërkesë të dorëzuar pas hyrjes së Traktatit në fuqi, edhe nëse veprat relevante janë kryer para hyrjes së tij në fuqi.

Duke qenë dëshmitarë, i poshtë-nënshkruari, me autorizime adekuate nga Qeveritë përkatëse, nënshkruajti këtë Traktat.

EKZEKUTUAR në Prishtinë në këtë ditë 19 të muajit Qershorë të vitit 2013
në dy kopje të gjuhës shqipe, serbe, italiane dhe angleze, dhe të gjitha tekstet janë autentike.

Në rast të mospërputhjeve rreth interpretimit, teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.


Për Qeverinë e Republikës së
së Kosovës


Për Qeverinë e Republikës së
së Italisë